



VENDIM

Nr. 85, Datë 07.06.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SH.A, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37 pika 2 gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a”, të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 Prot., datë 11.05.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 prot., datë 12.05.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Aplikimi i Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “b”, “c” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërmat “a” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- ❖ Vërtetimi nga Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë (neni 9, pika 2 gërmat “d”);
- ❖ Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, gërma “c”);
- ❖ Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/8, gërma “b”);
- ❖ Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka patur (neni 9, pika 4/8, gërma “c”);

Do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,
VENDIMIN

Nr. 85, Datë 07.06.2017

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SH.A, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

An tar t e Bordit

	Pro	Kund r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____